

**SUPREME COURT OF KOSOVO
GJYKATA SUPREME E KOSOVËS
VRHOVNI SUD KOSOVA**

**KOSOVO PROPERTY AGENCY (KPA) APPEALS PANEL
KOLEGJI I APELIT TË AKP-së
ŽALBENO VEĆE KAI**

GSK-KPA-A-85/2014

**Prishtinë,
14 Korrik 2016**

Në çështjen juridike të:

T.E.

Sraradran

Istog

Pala në ankesë

Kundër.

M.Z.

Rruga Lazarevacki drum nr. 7

Beograd

Republika e Serbisë

Pala përgjegjëse në ankesë

Kolegji i Apelit të AKP-së i Gjykatës Supreme të Kosovës, i përbërë nga Beshir Islami, kryetar i kolegjit, gjyqtarja e EULEX-it Anna Bednarek dhe Krasimir Mazgalov, gjyqtar i EULEX-it duke vendosur me ankesën e paraqitur kundër vendimit të Komisionit për Kërkesa Pronësore të Kosovës nr. KPCC/D/A/211/2013 (lënda e regjistruar në AKP me numër KPA91342) të datës 21 gusht 2013, pas këshillimit të mbajtur më 14 Korrik 2016, mori këtë:

AKTGJYKIM

1. Ankesa e paraqitur nga T.E. kundër vendimit të Komisionit për Kërkesa Pronësore të Kosovës nr. KPCC/D/A/211/2013, të datës 21 gusht 2013 refuzohet si e pabazuar.
2. Vendimi i Komisionit për Kërkesa Pronësore të Kosovës nr. KPCC/D/A/211/2013, i datës 21 gusht 2013, vërtetohet sa i përket kërkesës së regjistruar në AKP me numër KPA91342.

Përmbledhja e çështjeve procedurale dhe faktike:

1. Më 20 korrik 2006, pala përgjegjëse në ankesë M.Z. ka paraqitur kërkesë pranë Agjencisë Kosovare të Privatizimit (tani e tutje: AKP), në cilësinë e anëtarit të familjes të burrit të saj duke kërkuar konfirmimin e të drejtës pronësore dhe ri-posedimin e ngastrave të tokës: një pjesë të ngastrës së tokës nr. 2177/3 në sipërfaqe të pjesshme prej 00.13.00 ha (tani e tutje: prona e kërkuar) dhe të ngastrës së tokës 2178/1 në sipërfaqe prej 00.24.24 ha, të dyja me lokacion në fshatin Vitomiricë, Komuna e Pejës. Pala përgjegjëse në ankesë pretendon se burri i saj dhe vëllai i saj M., kanë fituar të drejtën pronësore mbi ngastrat e lartpërmendura të tokës në bazë të kontratës mbi shitblerjen e pasurisë së paluajtshme nr. 1397/90 të datës 26 dhjetor 1989 (tani e tutje: kontrata mbi shitblerjen nr.1397/90 e 26 dhjetorit 1989). Pala përgjegjëse në ankesë më tutje sqaroi se prona e kërkuar ka mbetur e regjistruar në emër të pronarit të mëparshëm M.I. (tani e tutje: pronari i mëparshëm) siç është shënuar në listën poseduese nr. 1050 të lëshuar më 12 mars 2002.
2. Në mbështetje të kërkesës, pala përgjegjëse në ankesë ka paraqitur në AKP dokumentet në vijim:
 - Kopjen e certifikatës së kurorëzimit nr. 200-2/99/530, të datës 9 qershor 1999 që tregon lidhjen familjare në mes të palës përgjegjëse në ankesë dhe bartësit të pretenduar të së drejtës pronësore.
 - Kopjen e listës poseduese nr. 1050 të lëshuar më 12 mars 2002 ku thuhet se M.I. është pronar i ngastrave të tokës: nr. 2177/3 në sipërfaqe të përgjithshme prej 00.08.69 ha dhe nr. 2178/1 në sipërfaqe prej 00.11.74 ha.
 - Kopjen e kontratës mbi shitblerjen e pasurisë së paluajtshme nr. 1397/90, të datës 26 dhjetor 1989, të lidhur në mes të M.I. (si shitës), dhe M, e M. Z. (si blerës) mbi shitblerjen e ngastrave të tokës nr. 2177/3 dhe 2178/1 në sipërfaqe në pjesshme prej 00.13.00 ha. Nënshkrimet poshtë kontratës ishin legalizuar nga Gjykata Komunale në Pejë më 14 qershor 1990.

3. Kërkesa është regjistruar në AKP me numër KPA13120. Më vonë, AKP-ja ka ndarë kërkesat dhe është krijuar një kërkesë e re me numër referues KPA91342. Kërkesa origjinale e regjistruar me numër KPA13120 i referohet ngastrës së tokës nr. 2178/1, kurse kërkesa e regjistruar me numër KPA91342 i referohet ngastrës së tokës nr. 2177/3.
4. Më 28 dhjetor 2010, është bërë njoftimi i kërkesës përmes publikimit në Gazetën Zyrtare të AKP-së nr. 10 dhe Buletinit të Zyrës për Prona të UNHCR-së
5. Më 28 dhjetor 2010, pala ankuese ka paraqitur përgjigje ndaj kërkesës duke pretenduar në të drejtën ligjore mbi pronën e kërkuar. Në mbështetje të pretendimeve të tij, pala ankuese ka dorëzuar në AKP dokumentet në vijim:
 - Kopjen e kontratës mbi shitblerjen e pronës së patundshme nr. 9596/02, të datës 25 janar 2002 (tani e tutje: kontrata mbi shitblerjen nr. 9596/02 e datës 25 janar 2002), të lidhur në mes të M.I. (si shitës), dhe T.H.E. (si blerës) mbi shitblerjen e ngastrave të tokës nr. 2177/2 në sipërfaqe prej 00.06.90 ha, nr. 2177/1 në sipërfaqe prej 00.08.69 ha dhe nr. 2178/1 në sipërfaqe prej 00.11.74 ha. Nënshkrimet poshtë kontratës ishin legalizuar nga Gjykata Komunale në Pejë më 7 nëntor 2002.
 - Kopjen e listës poseduese nr. 1050 të datës 22 dhjetor 2006, ku thuhet se M.I. është pronar i ngastrave të tokës nr. 2178/1 në sipërfaqe prej 00.06.33 ha .
 - Kopjen e listës poseduese nr. 585 të datës 22 dhjetor 2006, ku thuhet se T.E. është pronar i ngastrave të tokës nr. 2177 në sipërfaqe të përgjithshme prej 00.21.00 ha.
 - Kopjen e planit kadastral të ngastrave nr. 2177/1, 2177/2, dhe nr. 2178/1 të datës 20 mars 1992 që tregon sipërfaqen totale të ngastrave të përmendura të tokës me 00.32.93 ha dhe pronar: M.I. .
 - Kopjen e planit kadastral të ngastrave nr. 2177 të datës 20 janar 2006, që tregon sipërfaqen prej 00.21.00 ha.
 - Kopjen e ekspertizës gjyqësore të lëshuar nga Departamenti për Gjeodezi dhe Kadastër i Komunës së Pejës në lëndën C. nr. 600/10 në përbërje të planit kadastral në ngastrave: nr. 2177 (që tregon sipërfaqen prej 00.21.00 ha), 2178/1 (që tregon sipërfaqen prej 00.06.33 ha) dhe 2178/2 (që tregon sipërfaqen prej 00.12.50 ha) të datës 1 mars 2011.
 - Kopjen e ekspertizës gjyqësore të lëshuar nga Departamenti për Gjeodezi dhe Kadastër i Komunës së Pejës në lëndën C. nr. 600/10 më 18 korrik 2011 që identifikon matjet dhe cakton kufijtë e ngastrës së tokës nr. 2177 (në sipërfaqe të përgjithshme prej 00.21.00 ha) dhe ngastrës së tokës nr. 2178/1.
 - Kopjen e aktgjykimit të Gjykatës së Qarkut në Pejë të lëshuar në lëndën Ac.nr. 24/12 më 5 mars 2012 i cili anulon aktgjykimin e lëshuar nga Gjykata Komunale në Pejë në lëndën C. nr. 600/10 më 20 tetor 2011.
6. Më 30 nëntor 2010, AKP-ja ka verifikuar pozitivisht certifikatën e kurorëzimit nr. 200-2/99/530, të datës 9 qershor 1999. Zyra për regjistrim civil ka konfirmuar se certifikata është e regjistruar në librin e kurorëzimeve, që për tani gjendet në Kragujevc, Republikën e Serbisë. Në të njëjtën ditë, kontrata mbi shitblerjen nr. 1397/90 e datës 26 dhjetor 1989

është verifikuar nga Gjykata Komunale në Pejë. Kopja e kontratës i është bashkangjitur raportit të verifikimit.

7. Më 9 dhjetor 2010, AKP-ja ka tentuar të verifikojë listën poseduese nr. 1050 të datës 12 mars 2002 të dorëzuar nga pala përgjegjëse në ankesë. Në raport të verifikimit AKP-ja ka treguar se Departamenti për Gjeodezi dhe Kadastër i Komunës së Pejës ka konfirmuar ekzistencën e listës poseduese nr. 1050; megjithatë, lista është përditësuar në bazë të kontratës së shitblerjes nr. 9596/02 të datës 25 janar 2002. Në këtë mënyrë, ngastra e tokës nr. 2178/1 është regjistruar në listën poseduese nr. 1050 në emër të M.I. ; kurse ngastra e tokës nr. 2177/3 nuk ka figuruar në shënimet kadastrale. Në raport të verifikimit më tutje thuhet se ngastra e tokës nr. 2177 është e renditur në listën poseduese nr. 585 në emër të palës ankuese.
8. Më 30 tetor 2012, AKP-ja ka verifikuar pozitivisht kontratën e shitblerjes nr. 9596/02 të datës 25 janar 2002 në Gjykatën Komunale në Pejë. Kopja e kontratës i është bashkangjitur raportit të verifikimit.
9. Më 21 gusht 2013, Komisioni për Kërkesa Pronësore i Kosovës (tani e tutje: KKPK) me anë të vendimit KPCC/D/A/211/2013 (tani e tutje: vendimi i KKPK-së) ka pranuar kërkesën dhe ka vendosur se ka mjaft prova për ta vërtetuar pronësinë e palës përgjegjëse në ankesë për ½ pjesë ideale të pronës së kërkuar. Në arsyetimin e vendimit (paragrafët 22-30), KKPK-ja vëren se pala përgjegjëse në ankesë ka deklaruar, se burri i saj ishte bashkëpronar i pjesëve të ngastrave të tokës nr. 2177/3 dhe 2178/1 në sipërfaqe të përgjithshme prej 00.13.00 ha pa specifikuar se cilat pjesë së secilës ngastër ishin subjekt i shitblerjes. Në mbështetje të kërkesës së saj, pala përgjegjëse në ankesë ka dorëzuar kontratën e shitblerjes nr. 1397/90 të datës 26 dhjetor 1989, dhe listën poseduese nr. 1050 të lëshuar më 12 mars 2002. KKPK-ja më tutje vëren se pala ankuese pretendon se ka blerë pronën e kërkuar. Në mbështetje të këtij qëndrimi, pala ankuese ka dorëzuar kontratën e shitblerjes nr. 9596/02 të datës 25 janar 2002. KKPK-ja fillimisht ka vërejtur ekzistencën e mospërputhjeve në numrat e ngastrave të kërkuara siç është shënuar në shënimet kadastrale. KKPK-ja arrin në përfundim se ngastra e tokës nr. 2177/3 në sipërfaqe prej 00.08.69 ha ishte renditur gabimisht në listën poseduese të vjetruar nr. 1050 të lëshuar më 12 mars 2002, dhe është dashur të shënohet si ngastra e tokës nr. 2177/1. KKPK-ja më tutje vëren ndryshime në regjistrimin e ngastrave relevante. Në bazë të listës poseduese nr. 1050 të datës 12 mars 2002, ngastra e tokës nr. 2177/1 është në sipërfaqe prej 00.08.69 ha, dhe ngastra e tokës nr. 2178/1 është në sipërfaqe prej 00.11.24 ha. Ngjashëm, në kontratën e shitblerjes nr. 9596/02 të datës 25 janar 2002, shënohet se ngastra e tokës nr.2177/2 është në sipërfaqe prej 00.06.90 ha, nr. 2177/1 është në sipërfaqe prej 00.08.69 ha dhe nr. 2178/1 është në sipërfaqe prej 00.11.74 ha. Pas kontratës së fundit të shitblerjes ngastrat e tokës nr. 2177/1, 2177/2 dhe një pjesë e ngastrës nr. 2178/1 (më saktë 00.05.41 ha) ishin konsoliduar. Ato ngastra ishin konsoliduar në një ngastër të re të tokës me nr. 2177 në sipërfaqe totale prej 00.21.00 ha. Ngastra e konsoliduar nr. 2177 ishte regjistruar në emër të palës ankuese në listën e përditësuar poseduese nr. 585. Kurse, madhësia e ngastrës së tokës nr. 2178/1 ishte reduktuar nga 00.11.24 ha në 00.06.33 ha dhe është regjistruar në listën e përditësuar poseduese nr. 1050 në emër të pronarit të mëparshëm.

10. Duke u bazuar në analizën e përmendur, KKPK-ja ka arritur në përfundim se pala përgjegjëse në ankesë ka ofruar prova të mjaftueshme për të dëshmuar të drejtën pronësore mbi ngastrën e tokës nr. 2178/1 në sipërfaqe prej 00.06.33 ha (Kërkesa nr. KPA13120). Duke marrë parasysh se pala përgjegjëse në ankesë ka blerë në total 00.13.00 ha pa specifikuar pjesët e blera të ngastrave, KKPK-ja ka arritur në përfundim se pjesa e mbetur e tokës së blerë (më saktë 00.06.67 ha) do të konsiderohet si pjesë e ngastrës së tokës nr. 2177. KKPK-ja më tutje vëren se pronari i mëparshëm kishte shitur ngastrën e tokës nr. 2177/1 dy herë. Pas lidhjes së kontratës së shitblerjes në vitin 1989, pronari i mëparshëm nuk posedonte më të drejtën pronësore mbi pjesën e ngastrës së tokës nr. 2177/1 në përbërje të 00.06.67 ha. Si rezultat i kësaj, kontrata e shitblerjes se lidhur më 2002 me palën ankuese nuk ka mundur ta bënte bartjen e të drejtës pronësore të pjesës së përmendur të ngastrës te pala ankuese. Në këtë mënyrë, KKPK-ja konstaton se kërkesa e regjistruar me numër KPA91342 përkitazi me sipërfaqen 00.06.67 ha të ngastrës së tokës nr. 2177 duhet të pranohet.
11. Vendimi i KKPK-së është dorëzuar te pala përgjegjëse në ankesë më 20 dhjetor 2013. Pala ankuese e ka pranuar vendimin më 17 dhjetor 2013. Më 9 janar 2014 pala ankuese ka paraqitur ankesë kundër vendimit të KKPK-së. Më 21 maj 2014, pala përgjegjëse në ankesë ka paraqitur përgjigje ndaj ankesës.
12. Më 9 nëntor 2014, Gjykata Supreme ka kërkuar nga pala përgjegjëse në ankesë të dorëzojë certifikatën e vdekjes së burrit të saj dhe vendimin mbi trashëgiminë, për të sqaruar rrethanat në të cilat kishte ardhur deri te humbja e pronës, dhe për të njoftuar nëse aktgjykimi i Gjykatës Komonale në Pejë ishte i formës së prerë. Më 18 dhjetor 2015, pala përgjegjëse në ankesë ka dorëzuar informacionin e kërkuar.

Pretendimet e palëve

13. Pala ankuese pretendon se vendimi i KKPK-së është i bazuar në vërtetim të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe me zbatim të gabuar të ligjit material, dhe kërkon nga Gjykata Supreme ta anulojë vendimin e KKPK-së. Pala ankuese më tutje sqaron se e ka blerë pronën bujqësore në sipërfaqe prej 00.21.00 ha in 1994; megjithatë ai nuk ka mundur ta bartë pronën në regjistër në emër të tij për shkak të legjislacionit diskriminues. Kontrata e dytë e shitblerjes ishte lidhur me pronarin e mëparshëm në vitin 2002. Pala ankuese pretendon se KKPK-ja gabimisht ka arritur në përfundim se sipërfaqja prej 00.06.67 ha është e inkorporuar në ngastrën nr. 2177. Pala ankuese është e mendimit se kjo pjesë e tokës është jashtë ngastrës nr. 2177 siç është përcaktuar me aktgjykimin e Gjykatës Komonale të Pejës të nxjerrë në lëndën C nr. 191/12.
14. Më 21 maj 2014, pala përgjegjëse në ankesë ka dorëzuar përgjigje ndaj ankesës duke kërkuar nga Gjykata Supreme ta refuzojë ankesën si të pabazuar. Pala përgjegjëse në ankesë tregon se Kontrata e shitblerjes e vitit 1994 e dorëzuar nga pala ankuese në ankesën e tij nuk ka të bëjë me ngastrën e tokës nr. 2177. Ajo më tutje parashtron se KKPK-ja e ka shqyrtuar drejt kërkesën, duke u bazuar në dokumentet që janë paraqitur. Pala përgjegjëse në ankesë më tutje tregon se pala ankuese ka zaptuar tokën e saj në

mënyrë të paligjshme prej vitit 1999, dhe se ai dëshiron ta zgjasë këtë zaptim të paligjshëm ma anë të paraqitjes së ankesës.

Arsyetimi ligjor

15. Gjykata Supreme e Kosovës ka gjetur se vendimi i apeluar i KKPK-së ishte nxjerrë me vërtetim të plotë dhe të drejtë të gjendjes faktike dhe si ligji material ashtu edhe ligji procedural janë zbatuar drejt; prandaj, ankesa refuzohet si e pabazuar.

Provat e reja materiale

16. Në bazë të nenit 12.11 të Ligjit nr. 03/L-079 për ndryshimin e Rregullores së UNIK-ut 2006/50 (tani e tutje: Rregullorja e UNMIK-ut 2006/50), *Faktet e reja dhe dëshmitë materiale të paraqitura nga cilado palë lidhur me ankesën nuk pranohen dhe nuk shqyrtohen nga Gjykata Supreme përpos nëse tregohet se faktet dhe dëshmitë e tilla me arsye nuk kanë mundur të jenë të njohura për palën në fjalë.* Gjykata Supreme vëren se bashkë me ankesën e tij, pala ankuese ka dorëzuar kontratën mbi shitblerjen e pronës së paluajtshme, të datës 15 korrik 1994. Gjykata Supreme vëren se kjo kontratë nuk ishte paraqitur para KKPK-së dhe nuk ishte shqyrtuar gjatë procedurës në shkallë të parë. Për më shumë, pala ankuese nuk ka ofruar asnjë justifikim për të treguar pse nuk ishte dorëzuar kontrata mbi shitblerjen gjatë procedurës në shkallë të parë. Për këtë arsye, Gjykata Supreme e konsideron kontratën mbi shitblerjen e datës 15 korrik 1994si provë të re e cila nuk do të merret parasysh në marrjen e vendimit mbi lëndën.

Meritat e lëndës

17. Fillimisht, Gjykata Supreme konsideron se konstatimi i Komisionit lidhur me numrat dhe sipërfaqen e të gjitha ngastrave të tokës është i saktë. Analiza në atë aksept ishte e domosdoshme pasi pala përgjegjëse në ankesë në kërkesën e saj ka shënuar numra dhe sipërfaqe të gabuara të ngastrave të atëhershme dhe të tanishme. Pala ankuese megjithatë pretendon se toka e kërkuar është jashtë ngastrës nr. 2177 sikurse është përcaktuar me aktgjykimin e Gjykatës Komonale të Pejës të lëshuar në lëndën me numër C 191/12. Gjykata Supreme vëren se procedura para Gjykatës Komonale të Pejës ishte iniciuar nga pala përgjegjëse në ankesë më 5 shkurt 2008 dhe më vonë ishte ndryshuar më 10 shtator 2012. Njëkohësisht, pala përgjegjëse në ankesë paraqiti kërkesën para AKP-së më 20 qershor 2006. Pastaj, pala përgjegjëse në ankesë ka iniciuar procedurën lidhur me çështjen e njëjtë ligjore para dy institucioneve, e para ishte kërkesa e paraqitur para AKP-së.

18. Gjykata Supreme vëren se çështja e juridiksionit të AKP-së në krahasim me atë të gjykatave vendore është e rregulluar me nenin 18 të Rregullores së UNMIK-ut 2006/50, i cili përcakton: *dispozitat e kësaj Rregulloreje zbatohen për çdo kërkesë nga neni 3.1 i kësaj Rregulloreje që është parashtruar pranë gjykatës me kompetencë territoriale, me kusht që procedura gjyqësore lidhur me kërkesën e tillë të mos ketë filluar para datës së hyrjes në fuqi të kësaj Rregulloreje.* Kjo fjali vërteton se kërkesat e parashtruara pranë AKP-së pas hyrjes në fuqi të

- Rregullores së UNMIK-ut 2006/50 do të gjykohen nga AKP-ja e jo nga gjykatat vendore. Si të tillë, Gjykata Supreme konfirmon se AKP-ja ka kompetencë mbi kërkesën e palës përgjegjëse në ankesë dhe fakti se aktgjykimi i nxjerrë në lëndën C. 191/12 nga Gjykata Komunale e Pejës nuk e përjashton kompetencën e AKP-së si dhe të Gjykatës Supreme. Prandaj, nuk do të merret parasysh në procedurën e tanishme.
19. Për këtë arsye, Gjykata Supreme përkrah arsyetimin e KKPK-së duke sqaruar kronologjinë e regjistrimit të ngastrave të tokës nr. 2177/1, 2177/2, dhe 2178/1, dhe konsideron se KKPK-ja ka përcaktuar drejt se një pjesë e ngastrës nr. 2177 në sipërfaqe prej 00.06.67 ha është subjekt i kërkesës KPA91342.
20. Pala ankuese pretendon se ai është pronari i tërë ngastrës nr. 2177 pasi e ka blerë atë nga pronari i mëparshëm në vitin 2002. Pala përgjegjëse në ankesë, në anën tjetër ka paraqitur një kontratë mbi shitblerjen e një pjese të ngastrës nr. 2177 nga pronari i mëparshëm në vitin 1989. Të dy kontratat janë vërtetuar nga Gjykata Komunale në Pejë. Përveç kësaj, AKP-ja ka vërtetuar autenticitetin e dy kontratave. Gjykata Supreme konstaton se pronari i mëparshëm e ka shitur dy herë një pjesë të ngastrës nr. 2177 në sipërfaqe prej 00.06.67 ha.
21. Gjykata Supreme vëren se nenet 51(1) dhe 52 të Ligjit mbi Kontratat dhe Detyrimet (Gazeta zyrtare e SAP Kosovë Nr.40/53 dhe 57/54) (më tej: Ligji mbi Kontratat dhe Detyrimet) përcakton se çdo detyrim kontraktor duhet të ketë një bazë të lejuar dhe në rast se nuk ka një baze të tillë, kontrata do të konsiderohet si e pavlefshme. Gjykata Supreme konsideron se pronari i mëparshëm ka transferuar të drejtat pronësore për një pjese të ngastrës nr.2177 me sipërfaqe prej 00.06.67 ha, pasi ka përfunduar kontratën e shitjes më 26 dhjetor 1989. Nëpërmjet kësaj kontrate të drejtat pronësore i janë transferuar burrit të palës përgjegjëse në ankesë dhe vëllait të tij. Në këto kushte, pronari i mëparshëm nuk ka pasur tagër ligjor për të transferuar edhe një here tek pala ankuese të drejtën e pronësisë për të njëjtën ngastër me nr.2177. Për këtë arsye, Gjykata Supreme përkrah vendimin e KKPK-së për të pranuar kërkesën e palës përgjegjëse në ankesë lidhur me pjesën e ngastrës nr.2177 me sipërfaqe 00.06.67 ha.
22. Gjykata Supreme më tej vëren se neni 54 i Ligjit mbi Kontratat dhe Detyrimet tregon se pala e cila është në mirëbesim mund të kërkojë dëmshpërblim për humbjen e pësuar për shkak të përfshirjes në një marrëdhënie kontraktore që nuk ka efekte ligjore. Për këtë qëllim, pala ankuese gëzon të drejtën për të kërkuar dëmshpërblim në gjykatën kompetente.
23. Të gjitha arsyet e lartpërmendura qojnë Gjykatën Supreme deri te konstatimi se KKPK-ja ka marrë vendim të drejtë për arsye të drejta kur ka pranuar kërkesën.
24. Rrjedhimisht, ankesa e palës ankuese refuzohet si e pabazuar dhe vendimi i apeluar i KKPK-së konfirmohet si i drejtë dhe i bazuar në zbatim të duhur të ligjit, në përputhje me nenin 13.3 (c) të Rregullores së UNMIK-ut 2006/50 të ndryshuar me Ligjin nr. 03/L-079.

Përfundim

25. Në bazë të asaj që u tha më lart dhe në përputhje me nenin 13.3.(c) të Ligjit nr. 03/L-079 me të cilin ndryshohet Rregullorja e UNMIK-ut 2006/50 dhe nenin 195, paragrafin 1(d) të Ligjit për Procedurën Kontestimore, është vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.
26. Ky aktgjykim nuk paragjykon mbi të drejtat e palës përgjegjëse në ankesë për ta drejtuar lëndën në gjykatë kompetente jashtë juridiksionit të përcaktuar me dispozitat e nenit 3.1 të Ligjit nr. 03/L-079.

Këshillë juridike

Në pajtim me nenin 13.6 të Rregullores së UNMIK-ut 2006/50, të ndryshuar me Ligjin 03/L-079, ky aktgjykim është i formës së prerë dhe nuk mund të kundërshtohet përmes mjeteve të zakonshme apo të jashtëzakonshme juridike.

Beshir Islami, kryetar i kolegjit

Anna Bednarek, gjyqtare e EULEX-it

Krasimir Mazgalov , gjyqtar i EULEX-it

Sandra Gudaityte, Referente e EULEX-it